

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. i Org.
Org. Unit: 09

Nr. Prot.
Prot. No: 801

Nr. i faqeve
Broj strana
No. pages: 7

Datë
Date: 20/05/2019

Dalëse
PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Departamenti i Tatimit ne Pronë

Departament za Poreza na Imovinu - Department of Property Tax

DATE/A:	20 MAJ 2019
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtorët e Financave dhe Pronës të Komunave Menaxheret e tatimit në pronë të Komunave
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Naim BAFTIU, sekretar i përgjithshëm, ME
CC:	
NGA/OD/FROM:	Shkelzen MORINA, Drejtor i Departamentit të Tatimit në Pronë-Ministria e Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim

Te nderuar,

Agjencioni Suedez Tatimor, në emër të Departamentit të Tatimit në Pronë është duke prodhuar disa video të shkurta në funksion të informimit sa më të mirë të tatimpaguesve. Ne jemi të vetëdijshëm që sa më të informuar që janë tatimpaguesit, aq më shumë shtohet besimi në tatimin në pronë dhe autoritetet që e administrojnë atë. Njëkohësisht, informimi i mirë është edhe mënyra më e mirë për të reduktuar ankesat, që shumë shpesh janë rezultat i mos-informimit.

Video të cilën po ju përcjellim ka të bëjë me lajmet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me tatimin në pronë, si datat e pagesës, afatet për ankesë, e aspekte të tjera, të cilat mund të gjinden duke vizituar uebfaqen tonë të tatimit në pronë. Ajo është duke u transmetuar në të gjitha kanalet televizive nacionale, në faqen Facebook të DTP-së, si dhe në banere nëpër portale të lajmeve.

Me qëllim të arritjes të sa më shumë tatimpaguesve, ne jemi duke ju përcjellur videon në mënyrë që të shfrytëzoni atë në çfarëdo mënyre që e shihni të përshtatshme. Atë mund t'a shfaqni në hapësirat e zyreve tuaja ku keni ekrane, në faqet tuaja Facebook, në faqet zyrtare të Komunave. Nëse dëshironi të arrini sa më shumë tatimpagues të komunave tuaja, ju mund edhe të paguani që ajo të shfaqet edhe në televizionet lokale nëpër komunat tuaja.

Agjencioni Suedez Tatimor dhe Departamenti i Tatimit në Pronë janë aktualisht duke punuar në prodhimin e një video për të informuar qytetarët rreth shtyrjes së datës për pagesë të këstit të parë të tatimit në pronë deri më 28 Qershor, e cila shumë shpejt do të filloj të transmetohet nëpër televizionet nacionale.

Është shumë me rëndësi që sa më shumë tatimpagues që është e mundur të informohen, në mënyrë që të shmangin interesin dhe gjobat të cilat zbatohen për vonesë të pagesës. Për këtë arsye, fuqimisht ju inkurajojmë që t'i shfrytëzoni të gjitha videot në çdo mënyrë që e shihni të përshtatshme për informim të tatimpaguesve.

Për çdo ndihmë apo sqarime, ju gjithmonë mund t'i drejtoheni Departamentit të Tatimit në Pronë.

Me respekt:

Shkelzen Morina
Drejtore DTP, MF

